



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:260238

Datë: 24.01.2022

Numri i dokumentit: 02636053

E.nr.1001/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: Sh.M., F.R., B.B., V.B.Q. dhe D.Q, të gjithë nga Shtimja, të cilët me autorizim i përfaqëson av Labinot Buzuku nga fsh Hajvali, Komuna e Prishtinës, kundër debitorit Komuna e Shtimes-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 24.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.1001/21, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1001/21, të datës 30.08.2021, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor C.nr.1311/19, të datës 13.07.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 24.12.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,495.85 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1001/21, më datë 24.01.2022

GJYQTARI
Faton Ajvazi